LIGJ
Nr.10 205, datë 23.12.2009

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE, HYRJA OSE QËNDRIMI I TË CILËVE ËSHTË I PALIGJSHËM"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për ripranimin e personave, hyrja ose qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6381, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARREVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE, HYRJA OSE QËNDRIMI I TË CILËVE ËSHTË I PALIGJSHËM

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Malit të Zi (të quajtura më poshtë "Palët kontraktuese"),

me dëshirën për të vazhduar bashkëpunimin me qëllim garantimin e zbatimit më të mirë të rregulloreve për fluksin e personave,

me dëshirën për të lehtësuar ripranimin dhe tranzitin e personave, hyrja ose qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm,

në frymën e bashkëpunimit në bazë të reciprocitetit,

duke pasur parasysh konventën europiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut të adoptuar në Romë, më 4 nëntor 1950 dhe konventën që flet për statusin e refugjatëve të 28 korrikut 1951, të amenduar dhe shtuar nga protokolli në lidhje me statusin e refugjatëve, të adoptuar në Nju Jork më 31 janar 1967;

të vensosura për të parandaluar migracionin e paligjshëm,

ranë dakord për sa vijon:

I
PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Shtetas i Republikës së Shqipërisë” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.

b) “Shtetas i Malit të Zi” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Malit të Zi, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.

c) “Shtetas i vendit të tretë” do të thotë çdo person i cili mban shtetësi të ndryshme nga ajo e Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi.

d) “Person pa shtetësi” do të thotë çdo person i cili nuk zotëron shtetësinë e asnjë shteti.

e) “Leje qëndrimi” do të thotë një leje e çdo tipi, e lëshuar nga Republika e Shqipërisë ose Mali i Zi, që i jep të drejtë një personi të qëndrojë në territorin e asaj pale kontraktuese. Kjo nuk do të përfshijë lejet e përkohshme për të qëndruar në territorin e shtetit të saj në lidhje me procedurat e aplikimit për azil ose një aplikimi për leje qëndrimi.

f) “Vizë” do të thotë një autorizim për të hyrë, qëndruar ose kaluar përmes territorit të saj, lëshuar nga njëra prej palëve kontraktuese, kjo nuk do të përfshijë vizën e tranzitit aeroportual.

g) “Shtet kërkues” do të thotë shteti që dorëzon një aplikim ripranimi, pranimi ose tranzitimi.

h) “Shtet i kërkuar” do të thotë shteti të cilit i drejtohet aplikimi për ripranim ose tranzit.

i) “Autoriteti kompetent” do të thotë çdo autoritet kombëtar përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

j) “Tranzit” do të thotë kalimi i një qytetari të një vendi të tretë ose personi pashtetësi përmes territorit të shtetit të kërkuar, ndërsa udhëton nga shteti kërkues drejt vendit të destinacionit.

k) “Ripranim” do të thotë transferimi nga shteti kërkues dhe pranimi nga shteti i kërkuar i personave (shtetas të shtetit të kërkuar, ose qytetarë të vendeve të treta ose persona pa shtetësi), të cilët kanë hyrë, qëndrojnë ose banojnë në palën kërkuese, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

II

RIPRANIMI I SHTETASVE TË PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 2

1. Secila palë kontraktuese do të ripranojë në territorin e saj, me kërkesën e palës tjetër kontraktuese dhe pa formalitete të tjera, një person që qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese, nëse provohet ose prezumohet në mënyrë të vlefshme se ky person ka shtetësinë e palës kontraktuese të kërkuar.

2. Pala kontraktuese kërkuese do të ripranojë personin e përmendur në paragrafin 1 sipas të njëjtave kushte, nëse më vonë, në bazë të hetimeve të mëtejshme, përcaktohet se në kohën kur ai/ajo u transferua nga territori i palës kontraktuese kërkuese, ai/ajo nuk kishte shtetësinë e palës kontraktuese të kërkuar.

3. Në rastin kur personi i përmendur në paragrafin 1 synohet të transferohet dhe ka nevojë për kujdes të veçantë për arsye të moshës së tij/saj, gjendjes së keqe shëndetësore ose për ndonjë arsye tjetër të rëndësishme, çdo palë kontraktuese informon për këtë palën tjetër kontraktuese. Përgjigjja e palës kontraktuese të kërkuar në lidhje me vendin dhe orën e ripranimit të personit do të dërgohet pa vonesë, por jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga marrja e njoftimit.

Neni 3

1. Nëse shtetësia është provuar ose prezumuar në mënyrë të vlefshme, misioni diplomatik

ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar do të lëshojë pa vonesë, me kërkesë të palës kontraktuese kërkuese, një dokument udhëtimi zëvendësues që është i nevojshëm për kthimin e personit që do të transferohet në përputhje me nenin 1, paragrafi 1.

2. Kur ka dyshime për vlefshmërinë e shtetësisë së prezumuar, bazuar mbi dokumentet e protokollit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, pala kontraktuese e kërkuar, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar do të intervistojë personin brenda pesë (5) ditëve nga dorëzimi i kërkesës për ripranimin e personit. Pas miratimit të misionit diplomatik ose autoritetit konsullor, pala kontraktuese e kërkuar do ta kryejë këtë intervistim në kohën më të shkurtër të mundshme. Nëse intervistimi tregon se personi ka shtetësinë e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor do të lëshojë menjëherë një dokument udhëtimi zëvendësues.

III
RIPRANIMI I SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 4

1. Nëse personi që ka hyrë në territorin e palës kontraktuese kërkuese nuk arrin të përmbushë kushtet paraprake në fuqi për hyrje apo qëndrim, dhe nëse ky person ka një vizë të vlefshme ose një leje të vlefshme qëndrimi të lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar, kjo e fundit do ta ripranojë atë me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese dhe pa formalitete, përveç atyre të përcaktuara në këtë marrëveshje dhe në protokollin zbatues përkatës.

2. Nëse të dyja palët kontraktuese lëshuan një vizë ose një leje qëndrimi, detyrimi për të ripranuar personin do t'i takojë asaj pale kontraktuese, vlefshmëria e vizës ose lejes së qëndrimit të së cilës mbaron më vonë.

Neni 5

1. Pala kontraktuese e kërkuar do të ripranojë një shtetas të vendeve të treta apo person pa shtetësi me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese nëse kjo e fundit provon apo prezumon vlefshmërisht se personi i cili nuk i plotëson kërkesat efektive për hyrje apo qëndrim e ka kaluar kufirin shtetëror të palës kontraktuese kërkuese, pasi ka qëndruar në territorin e palës kontraktuese të kërkuar.

2. Detyrimi për të ripranuar sipas paragrafit 1 nuk do të zbatohet ndaj një personi, i cili në kohën e hyrjes së tij/saj në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese kishte një lejeqëndrimi të vlefshme të lëshuar nga ajo palë kontraktuese, ose të cilit i ishtë dhënë leje qëndrimi nga ajo palë kontraktuese pas hyrjes së tij/saj.

3. Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese do të pranojnë pa formalitete dhe vonesë (më tutje procedura përmbledhëse), çdo qytetar të vendeve të treta ose person pa shtetësi, nëse qytetari i vendeve të treta ose personi pa shtetësi kapet në territorin e palës tjetër kontraktuese brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve që nga kalimi i paligjshëm i kufirit. Procedura përmbledhëse do të përdoret vetëm për rastet kur autoritetet kompetente të palës kontraktuese kërkuese mund të japin prova për kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror të përbashkët nga ai person. Nëse një person refuzohet të pranohet sipas procedurës përmbledhëse, pranimi mund të kërkohet sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Nëse kushtet për ripranimin përmbledhës të personit janë përmbushur, autoritetet kompetente ose pala kontraktuese kërkuese do t'i njoftojë me faks, e-mail ose verbalisht autoritetet kompetente të palës kontraktuese të kërkuar. Një dosje mbi kthimin dhe pranimin e këtij personi duhet bërë.

5. Palët kontraktuese do të bëjnë përpjekje, sipas parapëlqimeve, për të transferuar një shtetas të një vendi të tretë për në shtetin e tij/saj të origjinës.

6. Pala kontraktuese kërkuese do të ripranojë një shtetas të një shteti të tretë ose një person pa shtetësi nën të njëjtat kushte, nëse më pas përcaktohet se në kohën e transferimit të tij/saj nga territori i shtetit të palës kontraktuese kërkuese, nuk plotësoheshin kushtet në kuadrin e nenit 4 paragrafi 1 dhe nenit 5 paragrafi 1.

Neni 6

Detyrimi për të pranuar sipas neneve 4 dhe 5 nuk do të zbatohet për një shtetas nga vendet e treta ose për një person pa shtetësi:

a) shtetasit nga vendet e treta, që u përkasin shteteve që kanë kufij të përbashkët shtetërorë me shtetin e palës kontraktuese kërkuese;

b) shtetasi nga vendet e treta ose personi pa shtetësi, që ka vizë të vlefshme ose leje qëndrimi të lëshuar nga pala kontraktuese kërkuese ose ata që pas hyrjes morën një leje qëndrimi për këtë shtet;

c) shtetasi nga vendet e treta ose personi pa shtetësi, që në kohën e dorëzimit të aplikimit të ripranimit, lanë më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj qëndrim në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese, vetëm nëse ai/ajo ka një leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga pala kontraktuese kërkuese;

d) shtetasi nga vendet e treta ose personi pa shtetësi, të cilit me dekret të pakthyeshëm i është dhënë statusi i refugjatit nga pala kontraktuese kërkuese në bazë të konventës për statusin e refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951) dhe protokollit për statusin e refugjatëve (Nju-Jork, 31 janar 1967);

e) shtetasi nga vendet e treta, i cili lë territorin shtetëror të palës kontraktuese të kërkuar dhe hyn në territorin shtetëror të palës kontraktuese kërkuese nga territori shtetëror në të cilin pala kontraktuese kërkuese lejohet ta kthejë këtë person sipas marrëveshjes dypalëshe të ripranimit.

IV. TRANZITI

Neni 7

1. Secila nga palët kontraktuese, me kërkesë me shkrim të palës tjetër, lejon tranzitimin në territorin e vet të shtetasve të vendeve të treta dhe do të sigurojë marrjen në dorëzim deri në shtetin e destinacionit ose në një tjetër shtet tranzit.

2. Pala kontraktuese kërkuese i garanton palës kontraktuese të kërkuar që personi, për të cilin autorizohet tranziti, ka një dokument dhe biletë udhëtimi për shtetin e destinacionit. Pala kontraktuese kërkuese është përgjegjëse për tranzitin e shtetasit të një vendi të tretë gjatë gjithë rrugës deri në shtetin e destinacionit.

3. Në rast të tranzitit në rrugë ajrore të shoqëruar me eskortë policie, pala kontraktuese kërkuese do ta sigurojë këtë për aq sa eskorta policore e palës kontraktuese kërkuese nuk del nga zona ndërkombëtare e aeroportit. Nëse tranziti me eskortë policore vazhdon përmes territorit të palës kontraktuese të kërkuar, kjo palë kontraktuese do të sigurojë eskortë policore.

Neni 8

1. Tranziti mund të refuzohet nëse një shtetas i një vendi të tretë është në rrezik për:

a) nëse personi është në rrezik për të qenë subjekt i torturës ose trajtimit çnjerëzor, ose degradues, ose ndëshkimit, ose dënimit me vdekje, ose persekutimit për arsye race, feje, kombësie, anëtarësie në një grup shoqëror të caktuar ose për arsye të pikëpamjeve të tij/saj politike në vendin e destinacionit ose një vendi tjetër tranzit;

b) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi do të jetë subjekt i ndjekjes penale ose sanksioneve në vendin e destinacionit ose një vendi tjetër tranzit, me përjashtim të kalimit të paligjshëm të kufijve shtetërorë; ose

c) nëse personit i është dhënë masa e sigurisë ose masa mbrojtëse e largimit nga territori i shtetit të palës kontraktuese të kërkuar.

2. Një person i pranuar për tranzit mund t'i kthehet palës kontraktuese kërkuese, nëse provat referuar në paragrafin 1, hidhen poshtë më vonë.

V
AFATET KOHORE

Neni 9

1. Pala kontraktuese e kërkuar do t'i përgjigjet kërkesës me shkrim, pa vonesë, në çdo rrethanë jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike që nga marrja e kërkesës. Në raste të veçanta, kur ka pengesa ligjore ose faktike, afati do të zgjatet me gjashtë (6) ditë pune. Nëse pas skadimit të afatit kohor të përmendur pala kontraktuese e kërkuar nuk përgjigjet, ripranimi do të quhet i pranuar. Çdo arsye për refuzimin e aplikimit të ripranimit duhet të jepet me shpjegim me shkrim.

2. Pala kontraktuese e kërkuar do ta pranojë pa vonesë personin, pranimi i të cilit është konfirmuar, në çdo rrethanë, jo më vonë se pesë (5) ditë pune që nga marrja e konfirmimit.

3. Pala kontraktuese e kërkuar do ta pranojë, pa vonesë, personin që ripranohet sipas procedurës përmbledhëse, në çdo rast jo më vonë se njëzet e katër (24) orë që nga marrja e konfirmimit të lajmërimit.

4. Në raste të veçanta, afati kohor i paragrafit 2 të këtij neni, në mënyrë që të eliminohen pengesat ligjore ose faktike, mund të shtyhet me gjashtë (6) ditë pune pas skadimit të afatit kohor referuar në paragrafin 2 të këtij neni.

5. Pala kontraktuese e kërkuar, që merr kërkesën për tranzit, sipas nenit 7 paragrafi 1 të kësaj marrëveshjeje, do të përgjigjet pa vonesë, në çdo rast jo më vonë se tri (3) ditë pune që nga marrja e kërkesës.

VI
KOSTOT

Neni 10

1. Kostot që lidhen me ripranimin e personave sipas nenit 2, nenit 4 dhe 5 deri në momentin që kryhet marrja në dorëzim e personit nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar, mbulohen nga pala kontraktuese kërkuese. Shpenzimet, në lidhje me kthimin e mundshëm të personave për t'u ripranuar, mbulohen gjithashtu nga pala kontraktuese kërkuese.

2. Kostot e transferimit të një shtetasi të një vendi të tretë deri në kufirin e vendit të destinacionit, duke përfshirë shpenzimet që lidhen me tranzitin përmes territorit të palës kontraktuese të kërkuar, si edhe kostot që lidhen me një kthim të mundshëm të tij/saj mbulohen nga pala kontraktuese kërkuese.

VII
MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 11

1. Të dhënat personale të komunikuara, të cilat janë të nevojshme për qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, do të mbrohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm të palëve

kontraktuese.

2. Nëse zbatimi i kësaj marrëveshjeje kërkon shkëmbim të dhënash personale ndërmjet palëve kontraktuese, për personat, këto të dhëna mund të jenë vetëm në lidhje me:

a) të dhënat personale të personit që duhet të transferohet ose të ripranohet, të të afërmve të tij/saj (emri, mbiemri, emra të mëparshëm, pseudonime, emra të rremë, data dhe vendi i lindjes, gjinia, shtetësia);

b) pasaportën, kartën e identitetit, dokumente të tjera identiteti ose dokumente udhëtimi dhe lejekalimi (numri, data e skadimit, data e lëshimit, autoriteti lëshues, vendi i lëshimit);

c) të dhëna të tjera të nevojshme për të identifikuar personin që do të transferohet apo do të ripranohet;

d) vendin e qëndrimit dhe itinerarin;

e) lejeqëndrimin ose viza të lëshuara nga njëra prej palëve kontraktuese.

VIII
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 12

1. Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme dhe e Administratës Publike e Malit të Zi do të lidhin një protokoll zbatimi, në të cilin ato do të specifikojnë:

a) dokumetet që provojnë apo prezumojnë në mënyrë të vlefshme shtetësinë e personit për t'u ripranuar;

b) përmbajtjen e kërkesave për ripranimin dhe tranzitimin, mënyrën e paraqitjes dhe përpunimit të tyre;

c) mjete për të provuar apo për të prezumuar në mënyrë të vlefshme hyrjen apo qëndrimin në territorin e shtetit të palës kontraktuese;

d) mënyrat për të provuar kalimin e paligjshëm të kufirit;

d) autoritetet kompetente të autorizuara për të zbatuar këtë marrëveshje;

e) pikat e kalimit kufitar të përdorura për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 13

1. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në zbatimin dhe interpretimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Brenda 3 muajve që nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, autoritetet kompetente do të formojnë një komitet të përbashkët për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ripranimin e personave me hyrje ose qëndrim të paligjshëm.

3. Autoritetet kompetente do të kenë një shkëmbim të rregullt informacioni mbi kushtet për hyrjen e qëndrimin e të huajve.

4. Palët kontraktuese do ta njoftojnë njëra-tjetrën pa vonesë për të gjitha ndryshimet në lidhje me autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 14

1. Kjo marrëveshje nuk paragjykon detyrimet e palëve kontraktuese në lidhje me ripranimin e personave, që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare që janë të detyrueshme për palët kontraktuese.

2. Kjo marrëveshje nuk paragjykon zbatimin e konventës për statusin e refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951), amenduar dhe shtuar me protokollin për statusin e refugjatëve (Nju-

Jork, 31 janar 1967), dhe konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive thmelore të njeriut (Romë, 4 nëntor 1950).

3. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk pengojnë zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara nga palët kontraktuese në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Neni 15

1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë (30) pas ditës së shkëmbimit të njoftimeve nga palët kontraktuese, nëpërmjet të cilëve ato njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e kërkesave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Secila palë kontraktuese mund të pezullojë zbatimin e kësaj marrëveshjeje, plotësisht ose pjesërisht, me përjashtim të nenit 2, për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, rendit publik apo shëndetit publik. Palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën pa vonesë për marrjen e kësaj mase apo për anulimin e saj. Pezullimi i zbatimit të marrëveshjes do të hyjë në fuqi me dorëzimin e njoftimit të palës tjetër kontraktuese.

3. Secila palë kontraktuese mund ta denoncojë me shkrim marrëveshjen nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, marrëveshja do të skadojë në ditën e nëntëdhjetë (90) pas dorëzimit të njoftimit për përfundimin, palës tjetër kontraktuese.

Bërë në Podgoricë më 6.12.2009 në dy kopje origjinale, secila prej të cilave në gjuhën shqipe, në gjuhën malazeze dhe në gjuhën angleze, të gjitha njëlloj të barazvlefshme. Në rast interpretimi kontradiktor, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.